

TËNDO



Mendime dhe fakte
për mbrojtjen e të
dhënave tua personale

Botues:

Metamorfozis, Shkup
www.metamorphosis.org.mk

Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale
e Republikës së Maqedonisë
www.dzlp.mk

Për botuesit:

Bardhyl Jashari
Marijana Marushiq

Përkthimi:

Xhanije Iseini

Lektore:

Miftar Abdiu

Ilustrimet:

Brigada DSGN

Përpunimi dhe dizajni grafik:

www.brigada.com.mk

Shtypi:

Propoint



Ky botim është shtypur me ndihmën e FSHM-së.

Botimi i parë i kësaj broshure u botua me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian.

Falënderim i madh i takon Inspektoratit për mbrojtjen e të dhënave personale në Norvegji (www.datatilsynet.no), për lëshimin e një pjese nga përmbajtjet e fushatave të tyre për mbrojtjen e të dhënave personale, të cilat shërbyen si bazë për përpunimin e kësaj broshure.

ZGJEDHJA ËSHTË E JOTJA

Kjo broshurë ka për qëllim t'ju tregojë se sa e rëndësishme është mbrojtja e të dhënave tua personale, si mund të keqpërdoren dhe të shfrytëzohen nga të tjerët dhe në çfarë mënyre mund t'i mbrosh.

Disa nga përmbajtjet tashmë janë të njohura, ndërsa disa të tjera do të jenë krejtësisht të reja. Shpresojmë se kjo broshurë do t'ju ndihmojë të mendoni dhe të diskutoni për të drejtën tuaj personale dhe do t'ju tregojë disa koncepte krejtësisht të reja.

Qëllimi ynë është t'ju ndihmojmë ta bëni zgjedhjen e duhur.

Ti vendos!

Mbledhja prindërore mbaroi me sukses...



...ferri filloi atëherë kur profesori e gjeti punimin tim në Google!

Me siguri nuk shkon në mbledhje prindërore që të pranosh para të gjithëve se punimet që i ke shkruar në të vërtetë i ke shkarkuar nga interneti. Dhe vështirë është të ngresh dorën gjatë orës mësimore dhe t'u tregosh të tjerëve cilat veb-faqe i ke vizituar...

Nëse ke ndonjë sekret që dëshiron t'ia tregosh shokut tënd, me siguri nuk do ta publikosh në fletushkë dhe nuk do ta shpërndash nëpër lokale. Nëse bisedon me të dashurën në dhomën tënde, nuk do ta ftosh tezen tënde, që ka ardhur mysafir, t'i bashkëngjitet bisedës tuaj...

Gjithashtu, mund të vendosësh këto punë t'i ruash vetëm për vete...

Por, nuk je çdoherë aq anonim sa mendon që je!

Trokitje! Dera trokiti përsëri! Më në fund ti je vetëm. Ulesh në karrige. E ndez kompjuterin. Bisedon me shokët dhe shfleton në internet. I lënë vetë me vetveten, pa të shqetësuar prindërit. Bile edhe nëse dëshirojnë të hyjnë brenda, duhet patjetër të trokasin. Përderisa je në dhomën tënde, ti je patroni.

TI KE TË DREJTË
TË TË LËNË REHAT!

Mbrojtja e të dhënave personale nënkupton edhe respektim të rregullave që nuk janë të përcaktuara për sjellje të mirë. Nuk shikojmë përmes vrimës së çelësit, nuk i hapim letrat që i gjejmë në rrugë dhe nuk i tregojmë shokut derisa qëndrojmë në lokal, për problemet shëndetësore të të afërmve tanë.

Ekzistojnë punë që nuk dëshiron t'i ndash me të tjerët. Jo për shkak se janë joligjore apo për shkak se ke nevojë t'i fshehësh, por thjesht se ato janë punët tua private. Kështu është, sepse ti je ai që vendos se çka duhet të dinë të tjerët për ty dhe cilin informacion ta ruash për vete.

ZGJEDHJA ËSHTË E JOTJA

Ti vendos vetë se çka dëshiron të ndash me të tjerët dhe me kë. Shumë pak janë ata që dëshirojnë të pyesin në mënyrë të zëshme për rezultatet e testit nga chlamidia, derisa qëndrojnë duke pritur në ordinancën shëndetësore - posaçërisht kur presin shumë pacientë. Shumë pak njerëz do të dëshironin që fotografitë e tyre lakuriq të qarkullojnë përmes MMS dhe të rrezikojnë që për disa sekonda ato fotografi t'i marrin dashnorët, profesorët apo prindërit e tyre. Askush nuk dëshiron që dikush të gjurmojë

në punën e tij private, pa dallim a bëhet fjalë për byronë apo kompjuterin e tyre.

TI I CAKTON KUFIJTË

Nevoja për hapësirë personale, që respektohet nga të tjerët dhe në të cilën nuk ndërhyhet është ndryshe te çdo person. Shokët tuaj mund të kenë mendime të ndryshme për atë se çka është e drejta personale. Gjithashtu, qëndrimet për atë se çka është personale vazhdimisht ndryshojnë.

Disa punë që prindërit tuaj i konsiderojnë si private dhe për të cilët bisedojnë vetëm pas dyerve të mbyllura, ti pa u menduar fare i kishe ndarë me të tjerët. Ndonjëherë kemi nevojë të jemi anonim. Duhet të jemi të sigurt se askush nuk mund të dijë gjithçka për ne apo të shikojë se çka bëjmë ne. Kjo do të thotë se mund të shkosh te drejtori i shkollës, por askush të mos e kuptojë se çka ke biseduar me të.

Ti ke të drejtë ta mbyllësh derën dhe vet të vendosësh se kujt do t'ia hapësh.

ÇKA MENDON?

Deri ku qëndrojnë kufijtë që prindërit tuaj duhen të kenë të drejtë të dinë për ty? A duhet të jenë të njoftuar se çka ruan në raftin tënd intim? A duhet të kenë qasje në certifikatën tënde të bankës që të kontrollojnë si e shfrytëzon kartelën tënde? A është në rregull të dinë se cilat faqe të internetit i ke vizituar? Sa vjet duhet t'i mbushni që prindërit tuaj të mos kenë qasje në gjithçka që bëni? A duhet të ketë kufij të ndryshëm për shembujt e lartpërmendur dhe nëse ka, si duhet të definohen?

DETYRA:

Qëndrimet për atë se çka është personale dhe çka është e përshtatshme që të jetë e njohur për opinionin kanë ndryshuar.

Ka shembuj të ngjarjeve që janë treguar në televizion, në internet dhe në gazeta, të cilat para 20 viteve nuk janë emituar sepse në atë kohë janë konsideruar si private.

Trego si ndryshojnë kufijtë. Çka mendon, ku duhet të vendosen kufijtë sot?

Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale

Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale ka për qëllim që t'i të jesh i sigurt se të dhënat tuaja personale shfrytëzohen në mënyrë të drejtë dhe nuk keqpërdoren. Ky ligj e mbron të drejtën tuaj personale e cila mund të keqpërdoret gjatë përpunimit të të dhënave personale.

Të dhënat personale

E dhëna personale është kuptim që lidhet me personalitetin. Kjo do të thotë se emri juaj, moshë, adresa edhe numri i telefonit janë të dhëna tuaja personale, sepse këto të dhëna kanë të bëjnë vetëm me ty. Fotografitë që mund të të identifikojnë, gjithashtu janë të dhëna personale, madje edhe kur nuk është i shënuar emri juaj. Numri juaj i amzës e përmban ditën, muajin dhe vitin kur keni lindur, gjininë dhe vendin e lindjes. Numri juaj i amzës është e dhënë personale.

Pëlqimi

Duhet ta dini se të tjerët nuk mund t'i shfrytëzojnë të dhënat tuaja personale pa marrë pëlqimin tuaj. Pëlqimin duhet ta japësh në mënyrë vullnetare dhe pa detyrim, por atë mund ta tërheqësh në çdo kohë. Ky është rregull themelor, por ka edhe përjashtime. Për shembull, në shumë raste institucioneve u lejohet shënimi dhe shfrytëzimi i të dhënave tuaja personale pa marrë pëlqimi prej jush. Rregulla kryesore është kur ti i mbush 18 vjet, vetë të vendosësh se a do të japësh pëlqim që të dhënat tuaja të shfrytëzohen dhe përpunohen. Ndërsa, nëse i ke më pak se 18 vjet, secili që dëshiron t'i shfrytëzojë të dhënat tuaja personale duhet të marrë pëlqim nga prindërit tuaj. Nëse bëhet fjalë për të dhëna personale të ndjeshme (si për shembull të dhëna që kanë të bëjnë me shëndetin, jetën seksuale, veprimet kriminale etj.) çdoherë do të kërkohet pëlqim nga prindërit, derisa t'i mbushni 18 vjet.



Nuk jemi vetëm, edhe atëherë kur duhet të jemi

Ja një shembull nga Norvegjia. Një tinejxhere ka shkuar të rrëshqasë pa prindërit, me shoqërinë e saj. Por, a ka qenë me të vërtetë pa prindërit? Babai i saj ka parapaguar shërbimin për ndjekje të sigurt të vajzës përmes telefonit celular, ashtu që duke qenë në shtëpi para kompjuterit ka mbajtur llogari se ku gjendet ajo. Ai mendonte se nuk ka bërë asgjë të keqe duke e ndjekur në këtë mënyrë, edhe pse vajza e tij është pajtuar, përsëri ishte pak skeptike ndaj faktit se babai i saj mund ta përcjellë në çdo kohë. Prokurori për fëmijë në Norvegji, Reidar Hjermand, ishte skeptik në mënyrë ekstreme për formën e drejtë të kësaj procedure. Sipas mendimit të tij "sistemi me të cilin prindërit mund t'i përcjellin fëmijët e tyre në çdo kohë, në mënyrë të qartë paraqet shkelje të të drejtës private të fëmijëve.

Informimi dhe qasja

- Nëse pajtohesh t'i japësh të dhënat tuaja personale, ke të drejtë të jesh i informuar kush i mbledh këto të dhëna, për çka do t'i shfrytëzojë, a do t'i përcjellë deri te të tjerët? Ti ke të drejtë të jesh i informuar edhe për atë se kush ka qasje deri te të dhënat tuaja personale.
- Ti ke të drejtë të jesh i informuar se çfarë të dhënash personale ruajnë të tjerët për ty, për çka do t'i shfrytëzojnë dhe në çfarë mënyre kanë ardhur deri te të dhënat tuaja personale.
- Ti ke të drejtë të kërkosh që të dhënat tuaja që nuk janë të sakta dhe të kompletuara të korrigjohen.
- Të dhënat të cilat më nuk janë të nevojshme për qëllimin që kanë qenë të mbledhura duhet të fshihen.



Në shkollë është tmerrësisht mërzitshëm! - është vështirë

të qëndrosh në orën e informatikës para monitorit, e të mos biesh në sprovë të kërkosh diçka interesante në internet... Por, edhe pse qëndron në një kënd ku askush nuk mund të shohë në ekranin tuaj, ka shumë persona që mund të shikojnë se çka je duke bërë.



Shfletimi dhe bisedat në Messenger janë punë private dhe pikërisht për këtë dëshiron të jesh në qetësi, në shtëpi me dyer të mbyllura, vetëm që të jesh i sigurt.

Por, shumë lehtë harron se në botën e teknologjisë, dera është e hapur.

LEHTË ËSHTË TË KONTROLLOHET

Që t'u arrijnë e-mail-at personave që ua dërgon e gjithashtu edhe veb-faqet që i kërkon, që të dërgohen pikërisht në kompjuterin tuaj, kompjuterit tuaj i është caktuar adresa IP. Shumë shkolla kanë mbrojtje nga depërtimi i hakerëve dhe viruseve, që gjithashtu mundëson të lexohet adresa IP në çdo kompjuter, cilat veb-faqe janë vizituar nga cili kompjuter, sa herë dhe sa gjatë.

Të gjitha faqet që i ke vizituar janë të ruajtura në memorien e internet kërkuesit (history file). E gjithë kjo ruhet, ashtu që herën tjetër më

lehtë ta vizitosh faqen e njëjtë. Nëse nuk e shlyen historinë në kompjuterin tuaj, atëherë të tjerët shumë lehtë mund të shohin se cilat veb-faqe i ke vizituar.

Personat e paautorizuar mund të kenë qasje te e-mail porositë që i ke pranuar dhe dërguar. Nëse shokët që nuk i ke aq të afërt, vijnë deri te parulla juaj, do të kenë qasje për gjithçka që ka të bëjë me ty dhe gjithçka që është dërguar vetëm për ty. Ndonjëherë, kjo gjë mund të jetë e papëlqyeshme dhe poshtëruese për ty.

RREGULLI DHE PËRGJEGJËSIA

Shpeshherë, për ty nuk është me rëndësi se të tjerët mund të shohin se çka ke bërë tërë ditën apo në orën mësimore. Por, nuk është çdoherë kështu. Për këtë shkolla juaj ka rregulla për atë se çka mund të veprojnë nxënësit dhe çka arsimtarët në kompjuterët e shkollës. Ekziston kufiri deri ku profesorët kanë të drejtë të kenë qasje në aktivitetet tuaja në kompjuter, por njëkohësisht edhe nga ti kërkohet që të sillësh në mënyrë të përgjegjshme gjatë shfrytëzimit të kompjuterit.

Kur je i kyçur në internet nuk është çdoherë lehtë të kuptosh se a të përcjellë dikush apo jo. Kur je vet në kompjuterin tënd, ti ndoshta ndjehesh se je anonim dhe mendon se askush nuk të përcjellë se çka bën... Por nuk është kështu...

A MUND TA DIMI
SE KUSH JU PËRCJELL?

Si gazetë e hapur

Të tjerët mund të shikojnë se cilat veb-faqe i ke vizituar duke kontrolluar history files apo temporary files për tekst, fotografi apo e-mail porosi. Këto dosje në mënyrë automatike nuk shlyhen kur kërkuesi është i fikur. Nëse vetë nuk e shlyen përbajtjen e tyre, të tjerët shumë lehtë mund t'i shikojnë aktivitetet tuaja në internet. Me shfrytëzimin e kompjuterit në shkollë, bibliotekë apo në internet kafe, rreziku për t'iu qasur të dhënave që i lë ti prapa teje, është i madh.

Nga e dinë se kush jam unë?

Çdo herë kur je në internet, të caktohet IP adresa. Internet kërkuesi vëren kur je i kyçur dhe cila IP adresë të është përcaktuar. Veb faqja gjithashtu vëren se cilat IP adresa i ke vizituar. Nëse bëhet krahasimi i IP adresave dhe evidenca e kërkuesit mund të identifikohet adresa e vizitorit.

Shumë veb-faqe grumbullojnë të dhëna për atë se kush i viziton. Për këtë qëllim ata në kompjuterin tuaj ruajnë dosje të vogla të ashtuquajtura cookies. Çdoherë kur ta vizitosh faqen, ata kontrollojnë se a ka kompjuteri juaj cookie files dhe i vërejnë informacionet në të (emrin e shfrytëzuar dhe pinin që janë shfrytëzuar për hyrjen në faqe).

Ti mund të refuzosh të japësh leje që veb-faqet të vendosin cookies në kompjuterin tënd me përcaktimin e opcionit për të drejtën personale.

Por, rrezikon që disa veb-faqe të ta kufizojnë qasjen. Duhet të vendosësh çka është më me rëndësi, mbrojtja e të dhënave tuaja apo qasja veb-faqes.

I kapur në rrjetin e shkollës

Në një shkollë në lindje të Norvegjisë, një platformë për e-mësim ishte keqpërdorur nga disa nxënës. Një numër i madh i porosive shqetësuese të cilët përmbanin fjalë ofenduese ishin shënuar në chat room. Shfrytëzimi i nickname pengon identifikimin e dërguesit, kështu që chat room-i ishte i mbyllur për të gjithë. Por problemi vazhdoi edhe përmes e-postës. Profesori përgjegjës zbuloi se kodet dhe emrat e shfrytëzuar ishin të vjedhur, kështu që pjesëmarrësit ishin kapur dhe disa nxënës ishin dënuar duke ua ndaluar dërgimin e porosive.

Burimi: Romerikes Blad

ÇKA MENDON?

Kush mendon se duhet të ketë qasje te të dhënat e kompjuterit që e shfrytëzon në shkollë? Profesorët? Shokët e shkollës? Prindërit? Çka do të duhet ata të shikojnë dhe si duhet t'i shfrytëzojnë ato të dhëna? Nëse shkolla zbulon se diçka lëviz përmes rrjetit shkollor, a do të duhet profesori të hyjë në sistemin kompjuterik dhe të shoh se çka ndodh dhe kush qëndron pas kësaj?

DETYRA

Bisedo me shokët e klasës. Ndhimoheni njëri tjetrin që të gjeni mënyrë se si

- ta shlyeni historinë e internet kërkuesit
- t'i shlyeni të gjitha dosjet e përkohshme (temporal files)
- t'i ndërroni të dhënat personale në internet kërkuesin.

Cilat rregulla vlejnë në shkollën tënde për shfrytëzimin e kompjuterëve të shkollës? Pyetni se në shkollën tuaj a ka rregulla për të drejtën e profesorëve t'iu qasen të dhënave me të cilat ti punon në kompjuter. Çka mendon ti, a duhet shkolla të ketë të drejtë të kontrollojë apo jo?

Jepni propozim për rregullat dhe diskutoni për këtë gjatë orës mësimore.

E gjitha filloi si shaka...



Nuk ndani fotografi të shkruara nga dashnorja juaj duke i thënë shokëve “E MIRË ËSHTË, APO?”

Nëse e incizon argëtimin e Vitit të Ri me shokët tuaj, gjithsesi nuk do të thotë që incizimin në DVD t'ia dhurosh babit tënd për festë. Dhe nëse dëgjon diçka të keqe për ndonjë person që e njeh, nuk do të tentosh që ta rritësh autoritetin tënd duke e informuar policinë, profesorët apo bashkëshkollarët për këtë rast. Me siguri jo...

Ti vendos për atë se çka duhet të dinë të tjerët!

...por, pa u menduar shtypa tastin „Enter”!

Përshëndetje, Ky jam unë! Shikoni profilin tim! Më shiko në My Spaces! Facebook! Hi5! Prijateli.com.mk! Youtube! Piczo! Më shiko! Shkruaj! Voto për mua!

Interneti është fantastik. Ofron mundësi të pafundme: krijon veb-qafen tënde dhe viziton veb-faqe të tjera shkarkon muzikë dhe filma, bisedon me shoqërinë në Skype, ndan fotografi, por edhe sekrete të tjera intime. Mirëpo, njëkohësisht interneti është edhe i vrazhdë? Kur njëherë diçka do të tregohet apo të publikohet vonë është për të klikuar në pullën "Undo". Ajo nuk ekziston.

TË JE REDAKTOR

Shumë njerëz dëshirojnë të jenë të njohur. Disa paraqiten në emisione reale, të tjerët krijojnë veb-faqe dhe blog ku i publikojnë informacionet dhe fotografitë e tyre. Çka do që të zgjedhësh, do ta fitosh vëmendjen e kërkuar nga ato që i ke njohur, por edhe nga ato që nuk i ke njohur.

PËRGJEGJËSIA ËSHTË E MADHE

Çdo gazetë ka redaktor që është përgjegjës për të gjitha tekstet dhe fotografitë që botohen apo publikohen online. Paraqitja e gënjeshtreve, ofendimeve, fotografive jo legale dhe shpërndarja e racizmit mund t'u shkaktojnë dëme shumë personave dhe mund të jetë e dënueshme. Gazetarët dhe redaktorët e medimeve të ne, kanë rregullat e tyre etike të punës të cilat janë të përfshira në "Kodeksin e gazetarëve të Maqedonisë".

Ashtu siç redaktori i një gazete është përgjegjës për gazetën e tij, ashtu edhe ti je përgjegjës për gjithçka që do të publikosh online. Duhet të mendosh mirë për atë se çka do të shpallësh pa marrë parasysh se a bëhet fjalë për të dhënat tua personale apo për të dhënat e ndonjë personi tjetër - e njëjta vlen edhe për fotografitë. Me rëndësi është të jesh i informuar për përgjegjësinë tënde edhe atëherë kur publikon diçka në blog dhe në veb-faqe. Ajo që është shaka për ty, për dikë tjetër mund të jetë ofenduese dhe të shkaktojë dëm.

VONË ËSHTË PËR "UNDO"

Është argëtuese të krijosh dhe të publikosh informacione, të dhëna dhe fotografi për të tjerët dhe për vete. Qëndrimi në shtëpi para kompjuterit duket krejtësisht e pafajshme dhe e parrezikshme.

Në botën e internetit, shumë lehtë vendosen kufijtë në mes të asaj që është private dhe asaj që mund ta ndash me të tjerët. Kur ndonjë

tekst apo fotografi njëherë do të publikohet online, vështirë është të shlyhet nga rrjeti i internetit dhe e pamundur të mbrohet nga kopjimi dhe dërgimi. Informacionet tuaja dhe fotografitë mund të shkojnë në ndonjë veb-faqe për të cilën as që e ke ditur se ekziston dhe me të cilën nuk dëshiron të jesh i lidhur.

Mendo para se të klikosh "Enter"

ÇKA MENDON?

A je penduar ndonjëherë për publikimin e të dhënave tua personale apo për të dhënat e dikujt tjetër, nëse po, për çka je penduar?

Pse mendon se disa njerëz vendosin të publikojnë fotografi në veb-faqe siç janë: Picasa, Flickr, Piczo, My Space, Facebook apo Hi5?

DETYRA:

Shënoni emrin tuaj dhe mbiemrin në fushën e kërkimit

- Çka gjeni?

- A mund që informacioni i marrë të japë fotografi të saktë për atë se kush je ti? Pse jo/pse po?

Merrni kopje nga "Kodeksi i gazetarëve të Maqedonisë"

(<http://O.mk/kodeks-na-novinari>), lexoje me kujdes dhe përpiku t'i krijosh rregullat etike për publikimin e informacioneve, të dhënave dhe fotografive online.

Njëherë e përgjithmonë...

Informatat, të dhënat dhe fotografitë të cilat publikohen online mund të shlyhen, por ndonjëherë është vështirë të shlyhen në tërësi. Dikush mund ta ketë shkarkuar informacionin, të dhënën apo fotografinë, ta ketë dërguar në ndonjë veb-faqe apo ta ketë vendosur në ndonjë bazë të caktuar që mund të nxirret me kërkim.

Kërko pëlqim!

Gjithmonë kur të publikosh fotografi për një apo më shumë persona në Internet, duhet t'i pyesësh se a pajtohen apo jo dhe të marrësh pëlqimin e sigurt dhe të vërtetë PO.

Pëlqimi i dhënë njëherë nuk do të thotë se është i pandryshueshëm. Nëse njëri prej tyre njëherë ka thënë Po dhe e ka ndërruar mendimin, do të duhet ta tërheqësh fotografinë.

Çlirohuni!

Ja si duhet t'i shlyesh të dhënat që janë të publikuar në Internet për ty e që ti i konsideron të papëlqyeshme:

1. Bisedo me personin që i ka publikuar!

A mund të jesh i njoftuar se kush i ka publikuar të dhënat për ty Bisedo me personin që i ka publikuar të dhënat dhe kërko t'i shlyejë. Sa më shpejtë, aq më mirë.

Edhe më tej ke probleme?

2. Bisedo me Internet provajderin!

Bisedo me ekipin e Internet provajderit a do të mund që të ndihmojnë.

Probleme serioze?

3. Kontaktoni me Drejtorinë për mbrojtjen e të dhënave personale!

Mund të kontaktoni me Drejtorinë për mbrojtjen e të dhënave personale për të marrë këshillë për shlyerjen e të dhënave që nuk janë të dëshiruara në internet.

Drejtoria mund t'ju ndihmojë edhe për çështje të tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave personale.

Ka gjetur fotografinë e saj në veb-faqe raciste

Një vajzë nga Norvegjia ka publikuar fotografi në veb-faqe ku shpeshherë me bashkëmendimtarët e saj ka këmbyer fotografi dhe informacione të ndryshme që kishin të bëjnë me fotografinë në përgjithësi. Pas disa muajve rastësisht e ka gjetur fotografinë e saj në një veb-faqe që ishte me përmbajtje raciste. Me titull "Të bukurat norvegjeze! Ishin publikuar fotografi të 122 vajzave (duke e vendosur edhe fotografinë e saj) p a marrë pëlqimin e tyre dhe pa i informuar. Përmbajtja e cila qëndronte si sqarim i fotografive ishte "fotografi të publikuara për ata që nuk e duan rasën nordike".... Fotografitë kanë qëndruar të publikuara disa muaj duke mos e vërejtur asnjë nga vajzat. *Burimi:Inspektorati norvegjez për mbrojtjen e të dhënave personale.*

„Nuk mund të përmbahem më“

Viti n e kaluar unë dhe shoqëria ime argëtoheshim si të gjithë tinejxherët. Kaluam me të vërtetë shumë mirë, duke njohur shokë të rinj. U fotografuam dhe fotografitë i publikuam në veb-faqe. Kemi pasur edhe password dhe gjithçka çka duhej....! Mendonim se asgjë nuk mund të kalonte në kahe të kundërt. Por, kur filloi viti i ri shkollor shumë persona u informuan se ajo ishte veb-faqe argëtuese dhe ishin të interesuar për marrjen e password-it. Atëherë ndodhi diçka e tmerrshme me veb-faqen në të cilën i kishim vendosur fotografitë. Përnjëherë çdo kush kishte mundësi t'i shikonte edhe faqet ku qasja ishte e kufizuar. Më e keqja filloi atëherë kur u njoftuan prindërit. Në fund njëra nga nënat kontaktoi me shkollën dhe sqaroi gjithçka. Ne u desh të shkonim patjetër në bisedë te profesorët dhe këshilltarët. Gjithashtu ishin të ftuar edhe prindërit e mi, por për fat të mirë ata mendonin se ishte vetëm një pjesë e jetës së tinejxherëve të çdo fëmije. Më e keqja ishte që e gjithë shoqëria dinte gjithçka. Kur para një viti u regjistrova në shkollën e mesme, isha shumë e entuziazmuar dhe mezi prisja të shkoja, por tani më vjen turp të shkoj. Kam mësuar një mësim me vlerë - nuk do të publikoj më asgjë në veb-faqe, as fotografi e as ndonjë informacion. Tash ndjej se kam videokamerë e cila më ndjek gjithkund. *Përsëhendetje: „Anonim“*
Burimi: Aftenposten

Striptiz para gjithë botës

Një vajzë 14 vjeçare i ka pozuar dashnorit të saj në veb-kamerë. Pas disa javësh, çdokush kishte mundësi ta shikonte në YouTube. Ajo, që në fillim dukej e pafajshme dhe argëtuese u bë me të vërtetë një tragjedi. Në afat prej 19 orëve klipi ishte shikuar nga 600 persona. Babai i vajzës e njoftoi policinë për shpërndarjen e fotografive, ndërsa policia edhe më tej e ndjek rastin. *Burimi: Expressen se*



Kini kujdes nga njeriu me automobil të kuq!

Quhet Petrit, është përdhunues! Vazhdo më tutje. Kini kujdes nga njeriu me automobil të kuq! Quhet Petrit, është përdhunues..... Vazhdo më tutje. Kini kujdes nga njeriu me automobil të kuq! Quhet Petrit, është përdhunues...

DIKUSH
MUND TË
TA SHKA-
TËRROJË
AUTORITETIN!



Përmes porosive tekstuale fjalët enden si rrufe. Ka gjasa të mëdhe që Petriti të jetë përdhunues. Me të vërtetë mund të jetë e nevojshme të keni kujdes nga ai. Por, kush e ka dërguar porosinë e parë? A është në rregull ta dërgosh këtë porosi? A është e mundur që Petriti të mos jetë përdhunues, por ndoshta ia ka "vjedhur" femrën shokut dhe tash ai dëshiron të hakmerret?

ËSHTË E PAMUNDUR TË NDËRPRITET

Pasi ta ketë marrë dhenë ndonjë aferë, është lehtë që të ndërpritet. Kur njëherë do të dërgohet ndonjë fotografi përmes MMS nuk ka kthim prapa. Kur të çregjistrohesh nga MSN, vonë është të thuash se nuk e ke menduar atë që e ke shkruar. Kur akuzat për profesorin më të keq që i ke publikuar online do t'i lexojë ndonjë profesor, me siguri do të dënohesh nga ana e shkollës.

Për shumë njerëz jeta pa internet dhe telefon celular nuk ka kuptim. Bota bëhet gjithnjë e më e vogël, ndërsa rrethi i shoqërisë gjithnjë e më shumë zgjerohet. Telefonat celularë dhe interneti ofrojnë mundësi të shkëlqyera që gjeneratat e mëparshme asnjëherë nuk i kanë pasur. Por, njëkohësisht ofrojnë edhe mundësi që të lëndohet ndonjë person. Hulumtimet tregojnë se ngacmimet përmes telefonit celular dhe internetit janë dukuri shumë të shpeshta të të rinjtë. Aq të shpeshta janë shembujt kur dikush do të incizojë ndonjë rrahje në mes të nxënësve në oborrin e shkollës dhe ditën tjetër do ta publikojë në vebfaqe apo në blog. Shoku i mëparshëm e ka vjedhur identitetin e Florimit dhe

ka dërguar porosi me përmbajtje banale te grupi i shokëve. Nuk ka mënyrë më të lehtë për përhapjen e të dhënave që publikohen online.

MENDO ME KOKËN TËNDE!

Kur je i ulur pranë kompjuterit apo kur je me telefon celular në dorë, ti je ai që do të vendosësh se çka dëshiron të ndash me pjesën tjetër të botës. Ti e ke përgjegjësinë të mendosh para se ta dërgosh lajmin e mirë apo ofendimin për tjetrin.

Nëse nuk do ta bësh atë në jetën reale, mos e bën edhe në botën digjitale.

ÇKA MENDON?

Disa thonë se interneti dhe telefonat celularë ndihmojnë për komunikim më të lehtë, por edhe për ngacmimin e të tjerëve. Çka mendon ti?

Mendo për atë se cilat porosi i ke dërguar. Vallë me ndonjë porosi a e ke lënduar dikë dhe si?

Çka ke treguar apo ke bërë online, që asnjëherë nuk do ta bësh në jetën reale?

A ka ndodhur që dikush të publikojë ndonjë informacion për ty? Nëse përgjigja është po, a të ka pëlqyer ajo që e ke parë? Ai që e ka publikuar informacionin a ka kërkuar leje prej teje për ta dërguar informacionin?

Të dhënat flasin se:

- 15% e popullatës botërore në mënyrë të vetëdijshme e shfrytëzojnë internetin, ndërsa rreth 25% në mënyrë të pavetëdijshme (përmes telefonave, televizioneve të ndryshme). Nga ata, gjysma janë prej moshës 5 vjeçare deri në adoleshencë.
- Çdo fëmijë i tretë në shoqërinë informatike kanë faqe apo blog -un e tij.

Edhe diçka shkaqe për të qenë i kujdesshëm:

- Kërkimi i fjalës „enciklopedi“ në Google jep 214.000.000 rezultate, ndërsa fjala „seks“ jep 763.000.000 rezultate.
- Shtatë fëmijë më të moshuar se 10 vjet kanë marrë oferta seksuale përmes internetit.
- Me projektimet më të afërta, duke pasur parasysh se një numër i madh i veb- faqeve nuk dihet, në botë shfaqen rreth 20.000 faqe të reja pedofilie për çdo vit.

Dërguesi i gabuar

Porositë të cilat i merrni në telefonin celular nuk janë gjithmonë të dërguara nga personi që mendoni se është dërguesi. Ekzistojnë shumë shërbime online që mundësojnë çdokush të zgjedhë nga cili numër dëshiron të dërgojë porosi. Dërgimi i porosive me identitet të huaj nuk është i lejuar, ndërsa varësisht se për çka shfrytëzohen ato porosi, vendoset se a është kryer ndonjë vepër penale apo jo. Diçka që për dikë mund të jetë shaka, për të tjerët mund të paraqesë kërcënim serioz.

DETYRA:

Vizitoni Piczo, You Tube apo veb-faqe të ngjashme. A keni gjetur fotografi apo video klipe të cilat mund të jenë të dëmshme për autoritetin e ndonjë personi, të cilat nuk duhen të jenë të publikuara?

Kontrollo blogun tuaj apo blogun e klasës tënde. A ka të publikuar ndonjë informacion që ka të bëjë me personin që nuk e ka lejuar këtë?

E fajësuar për ofendim online

Pasi, e ka ofenduar bashkëbiseduesen e saj në online chat room duke i thënë fjalë më të këqija dhe sharrje, 17 vjeçarja nga Norvegjia ishte dënuar për shkatërrim të autoritetit të personit tjetër. Gjykata ka vendosur se porosia duhet të llogaritet si shqetësim publik dhe për shkak të kësaj nuk duhet të trajtohet dhe të mbrohet si “liri e të shprehurit”. Vajzës i është shqiptuar dënim me para.

“Ne gjithmonë jemi të njoftuar kush qëndron pas këtyre llojeve të shqetësimit. Njerëzit mendojnë se kur janë online gjithçka është anonime, por nuk janë të vetëdijshëm se gjithmonë lënë gjurmë elektronike”, ka theksuar pronari i veb- faqes.

Burimi: digj.no

Rrahja e incizuar

Ka ndodhur rrahje në oborin e shkollës. Shumë nxënës vijnë të shikojnë se si do të përfundojë. Shumë prej tyre e incizojnë rastin me telefona celularë. Më vonë klipet publikohen në YouTube. Çdo ditë publikohen 65.000 klipe të reja në YouTube Për një muaj në YouTube arrijnë 20 milion klipe, ndërsa i shikojnë njëmijë vizitorë. Publikimi i klipëve është jolegal, pa pëlqimin e atyre të cilat janë pjesëmarrës.

Burimi: Dagbladet

Veb-faqe me përmbajtje përplot me urrejtje


Kur një pjesëmarrëse e ndeshjes *Idol* pasi ka arritur në shtëpi, ka zbuluar se dy bashkëshkollaret e saja kanë krijuar veb-faqe në të cilën kanë publikuar përmbajtje përplot me urrejtje për atë. Mes tjerash, vizitorët e veb-faqes krenoheshin duke shkruar porosi shumë më të këqija për pjesëmarrësen e *Idol-it*.


“Komentet ishin të pabesueshme. Më e keqja ishte se në njërin anë të veb-faqes, kishte edhe forum, ku vizitorët kanë mundur të bisedojnë gjithçka për mua. Këto biseda lëndojnë dhe është e pamundur të mbrohesh nga ato. Më e keqja ishte që këtë situatë e filluan bashkëshkollaret e mia”, thotë vajza 18 vjeçare e cila pendohet që nuk e ka paraqitur rastin në polici. Udhëheqësi i klasës gjithashtu e ndan mendimin se ky tip i maltremitit në internet është absolutisht i papranueshëm. Veb-faqja ishte tërhequr, ndërsa nxënësit që ishin përgjegjës për krijimin e saj ishin dënuar me zvogëlimin e notave.

Burimi: Bergens Tidende



Dukej si truk i mirë por...





... harrova se kishte kamerë për mbikëqyrje të vendosur në një skaj!

Me siguri, në polici nuk do të dërgosh incizime nga aktivitetet tuaja të dyshuara, me qëllim që ta plotësosh dosjen.

Dhe nuk do të qëndrosh në tualet me derë të hapur në qendrën tregtare.

Kur je në gardërobën e ndonjë butiku, nuk bërtet „Më shikoni, jam i zhveshur!” duke dashur ta tërheqësh vëmendjen e punëtorëve në atë butik. Ndërsa nëse ke shkarkuar muzikë jolegale nga interneti, me siguri nuk do të shkosh në shtëpinë botuese ku do të thuash „E kam shkarkuar këtë!”

Me siguri nuk do ta bësh këtë, nëse ke zgjedhje...

e di çdoherë se kush të shikon?


Përtheqoje patentin e pantallonave. Mos e fut hundën gjithkund. Shiko a i ke flokët OK dhe a i ke të rregulluara pantallonat mirë. Kamerat incizojnë, të incizojnë edhe ty!

A ËSHTË MË SIGURT ME KAMERA PËR MBIKOYRJE?

Kamerat të ndjekin. Gjatë shëtitjes në qendër, gjatë shëtitjes në qendër tregtare, gjatë qëndrimit në ndonjë lokal, gjatë blerjes hamburger në kiosk, ndërsa është e mundur të ketë kamera edhe gjatë ushtrimeve apo gjatë provës së koleksionit të ri në butikun e dëshiruar. Sigurimi është shumë me rëndësi dhe është shkak i arsyeshëm për vendosjen e video mbikëqyrjes në më shumë vende, por...

A ËSHTË GJITHMONË I ARSYESHËM?

Videoincizimi mund të ndihmojë për gjetjen e kriminelëve dhe zgjidhjen e akteve kriminale siç janë vandalizmi, përdhunimi dhe vjedhja. Por, para se të sillët vendimi për instalimin e video mbikëqyrjes, është me rëndësi të mendohet për pasojat e mundshme të padëshiruara. Për çka është i nevojshëm videoincizimi? A mund incizimi ta cenojë të drejtën personale. A ekzistojnë aktivtetime të tjera që të ruhet siguria? Nuk ekzistojnë të dhëna që tregojnë se a është zvogëluar krimi me vendosjen e kamerave. Ajo që



ÇKA MENDON?

A ndihesh njësoj edhe atëherë kur e di se ndonjë kamerë të incizon? A është në rregull dikush tërë kohën të të përcjellë se çka bën?

Video mbikëqyrja në vendet publike siç janë shkollat dhe institucionet e tjera, në të vërtetë rezulton në përgjegjësi më të vogël për qeniet njerëzore? A e lëmë përgjegjësinë tonë në duart e kamerave?

Paramendonit këtë situatë - njërit nga shokët tuaj i kanë vjedhur para në gardërobën e shkollës. A duhet të ketë të instaluar kamerë në gardërobë? Nëse duhet, cili do të jetë qëllimi për vendosjen: të ndërpritet krimi apo të zgjidhet rasti më vonë? Cilat do të jenë pasojat nga instalimi i kamerave?

është e dukshme është se ndërrohet vetëm forma e zbatimit të kriminalitetit apo vendi ku ndodhin të njëjtat. Njerëzit nën ndikim të drogës dhe alkoolit, njerëzit me sëmundje mentale, nuk janë në gjendje të kuptojnë se ndonjë kamerë mund t'i incizojë, pikërisht për këtë parashtrohet pyetja, se sa kontribuon video mbikëqyrja për shoqëri më të sigurt. Shumë vështirë është që të bëhet dallimi se si silllemi ne si qenie njerëzore kur e dimë se jemi të incizuar dhe kur nuk jemi në dijeni se dikush na incizon.

Në situata të caktuara videoincizimi mund të sjellë deri në mosmarrëveshje.

Në disa vende kamerat janë instaluar me qëllim që të zbulohen personat e padëshiruar të cilëve do t'u kërkohet që ta lëshojnë lokalin, edhe pse nuk kanë bërë asgjë të keqe. Që të mënjanohe mosmarrëveshjet dhe keqpërdorimet e kamerave, me rëndësi të madhe është se ata që e kanë instaluar atë, të dinë në çfarë mënyre ta bëjnë këtë dhe si t'i ruajnë materialet e incizuara në pajtim me dispozitat e rëndësishme ligjore.

Rregullimi ligjor i videoincizimit

Në të gjitha vendet publike ku janë të vendosura kamerat duhet të ketë njoftim të qartë se objekti gjendet nën videobikëqyrje dhe të dihet se kush i ka vendosur. Incizimi sekret është i ndaluar. Është i ndaluar edhe tregimi i incizimit palës së tretë pa pëlqimin e tyre. Megjithatë incizimet mund t'i tregohen apo t'i jepen policisë. Incizimet duhet të ruhen në vende ku mund të kenë qasje vetëm personat e caktuar dhe të shlyhen në atë moment kur do të ndërpritet qëllimi për të cilën janë mbledhur.

Kamerat nuk janë çdoherë zgjidhja më e mirë

Britania e Madhe është vendi me më shumë kamera të instaluar për videoincizim - numri i atyre arrin deri në 4.2 milion. Ekipi i Universitetit të Liçesterit ka bërë hulumtim se si videoincizimi ka ndikuar në shfaqjen e kriminalitetit në disa sfera për mbrojtje. Kanë zbuluar se kriminaliteti ishte zvogëluar në dy nga gjithsej katërmëdhjetë sfera të cilat ishin nën videoincizim. Hulumtimet treguan se videoincizimi mund të ndihmojë në zvogëlimin e numrit të vjedhjeve dhe tradhtive, jo vetëm në një shkallë të caktuar dhe në territoret e definuara si të tendosura, siç janë shitoret apo hapësirat për parking. Ekzistojnë dëshmi të vogla për atë se videoincizimi në rrugë dhe në shitore ka ndikim pozitiv në ndërprerjen e dhunës në shoqëri.

DETYRA:

Shëtitni nëpër fqinjë. Shikoni ku ka të vendosura kamera. Pse janë të instaluar kamerat në ato vende? A mendoni se vendosja e këtyre kamerave ka efekt?

Si është e mundur që përgjegjësi i kamerave t'i keqpërdorë materialet e incizuara?

Ndjekja e vizitorëve të padëshiruar

Derisa sa policia e shfrytëzon videoincizimin për zbardhjen apo pengimin e rasteve të krimit, hulumtimet tregojnë se në disa vende evropiane kamerat më së shpeshti vendosen që të mund të "largohen" vizitorët e padëshiruar. Hulumtimet tregojnë se njerëzit të cilët i kontrollojnë kamerat më shpesh janë koncentruar në gjetjen e vizitorëve të padëshiruar, se sa në zbulimin e veprave kriminale.

Shkupi është qyteti "më i incizuar" në Maqedoni. Kamerat Incizojnë gjithkund në rrugë, qendër, qendra tregtare.

I incizuar me kamerë në gardërobë

Blerësit në një shitore sportive në Suedi ishin incizuar përderisa provonin rroba në gardërobë. Kamerat sekrete ishin zbuluar rastësisht nga ana e një gazete lokale. Sipas informatave të tyre, kamerat kishin incizuar më shumë se një vit. Sipas menaxherit të shitores, kamerat ishin vendosur me qëllim të pengimit të vjedhjes gjë që kishte ndodhur shumë shpesh. Kur e gjithë ndodhia doli në shesh menaxheri i tërhoqi kamerat.

Burimi: Aftenposten

Ju lutem më shumë mish në skarë!

Shumë persona të cilët punojnë në restorant, në pompa të benzinës, vazhdimisht kanë qenë të ftuar nga shefat e tyre të cilët kanë urdhëruar p.sh se duhet të vendosin më shumë mish në skarë. Si mund shefi ta dijë sa mish përgatitet në skarë, kur nuk ka qenë i pranishëm në restorant, ishin pyetur punëtorët. Ata filluan të dyshojnë se shefi e përcjell punën e tyre "drejtpërdrejt" nga shtëpia. Inspektimi që ishte realizuar me kërkesë të punëtorëve ka vërtetuar se punëtorët kanë pasur të drejtë, përkatësisht se shefi vazhdimisht i ka ndjekur nga shtëpia e tij. Shfrytëzimi i videoincizimit për kontrollimin e punëtorëve në këtë mënyrë konsiderohet si shkelje e të drejtës personale. Vendosja e kamerave duhet të bëhet në atë mënyrë që mos të incizohet çdo lëvizje e punëtorëve në vendin e punës.

Burimi: Inspektorati për mbrojtjen e të dhënave personale të Norvegjisë

I zënë në kurth

Një taksist e ka humbur kuletën e tij. Pas një kohe i janë lajmëruar nga shitorja në të cilën është gjetur kuleta dhe patenta e shoferit. Taksistit i është lejuar t'i shikojë incizimet nga kamera që ka incizuar shitorja, ku shihej se një djalë qëndronte i ulur në karrige, në vendin ku u gjetën kuleta dhe patenta e shoferit. Taksisti e njohu djalin, iu lajmërua në telefon dhe e akuzoi për vjedhje. Djali refuzonte se e ka vjedhur kuletën. Edhe pse fotografia tregonte se djali ishte ulur në karrigen e njëjtë ku ishin gjetur sendet e vjedhura, kjo nuk ishte aq e mjaftueshme të dëshmonte se djali me të vërtetë ishte vjedhësi. Menaxheri i shitores nuk kishte të drejtë t'i tregonte fotografitë ndonjë personi përveç policisë,

por përsëri fotografinë ia tregoi taksistit. Inspektorati për mbrojtjen e të dhënave personale kërkoi nga menaxheri në mënyrë të qartë t'i rregullojë procedurat për incizim dhe tregim të materialeve të incizuara.

Burimi: Inspektorati për mbrojtjen e të dhënave personale të Norvegjisë

Ti vendos kujt do t'i paraqitesh dhe kur! Operatori i telekomunikimit incizon! Ti vendos ku dhe për çka do ta shfrytëzosh kartelën! Banka incizon! Ti vendos cilët terme i kërkon në Google! Kërkuesi të incizon! Gjatë tërë një dite të rëndomtë, ti lë shumë gjurmë pas vetes. Shumë njerëz mund të jenë të interesuar për gjurmët të cilat pikërisht ti i ke lënë.

DIKUSH I NDOJËK GJURMËT TUA!

Data 11 shtator i vitit 2001: Terroristë fluturuan në qendrën tregtare botërore në New York. E gjithë bota perëndimore u fundos në frikë nga sulmet e reja terroriste. Ishin ndërmarrrë edhe masa të përforcuara të kontrollimit duke i kyçur edhe pasaportat e reja biometrike, dokumentet e shumta, ndjekje të bisedave përmes telefonave celularë dhe qarkullim të internetit - e gjithë kjo me qëllim të pengimit të sulmeve të reja dhe veprimeve të tjera kriminale.

PËRDORIMI DHE KEQPËRDORIMI

Rritja e frikës nga terrorizmi dhe krimi tjetër serioz do të thotë edhe zgjerim i kufijve të asaj që jemi në gjendje ta parashtrojmë si mbikëqyrje mbi aktivitetet tona. Zhvillimi i teknologjisë këtë zgjerim e bën të mundshëm dhe më të lehtë. Shumë njerëz mendojnë se ndjekja e gjurmëve elektronike të dikujt është punë pozitive që të ndërpritet kriminaliteti eventual, por a do të thotë kjo se të gjithë ne jemi të trajtuar si "të dyshuar" kur do të ndodhë diçka në të ardhmen?

Më parë asnjëherë nuk ka qenë e mundur të grumbullohen kaq shumë informacione dhe të dhëna për çdonjërin nga ne. Ata të cilët grumbullojnë të dhëna personale mund të sprovohen që t'i përdorin edhe për qëllime për të cilat nuk janë paraparë. Gjurmët elektronike mund të shfrytëzohen për qëllime që neve nuk na pëlqejnë,,siç janë qëllimet komerciale përkatësisht marketingu dhe shitja.

QËLLIMET E MIRA

Ekziston një numër i madh i firmave dhe personave të cilët mbledhin të dhëna për ty me qëllim që të ofrojnë disa shërbime të tyre që janë të dobishme. Me rëndësi është të vendosen rregulla të qarta për atë se kush ka të drejtë të grumbullojë të dhëna për të tjerët, si do të shfrytëzohen ato të dhëna, për çka do të shfrytëzohen dhe sa kohë do të ruhen. E dhëna që është mbledhur për një qëllim nuk guxon automatikisht të shfrytëzohet për ndonjë qëllim tjetër. Sa më shumë të dhënat tona incizohen. Dikush na përcjell dhe i grumbullon të dhënat tona personale edhe atëherë kur nuk bëjmë asgjë të keqe. Por disa personave kjo aspak nuk u pëlqen edhe pse e dinë se janë të pastër.

A është mbikëqyrja e arsyeshme çdoherë?



Industria e filmit dhe e muzikës kontrollojnë!

Ngarkimi (Upload) dhe shkarkimi (download) i filmave dhe i muzikës pa posedimin e të drejtës për kopjim është veprim jolegal. Ata të cilët e posedojnë të drejtën e autorit për muzikën dhe filmin humbin para të mëdha për shkak të shkarkimit ilegal nga interneti. Pikërisht nga këto shkaqe trupat mbikëqyrëse për mbrojtjen e të dhënave personale, në disa vende të UE-së japin leje për ndjekjen e shfrytëzimit jolegal të muzikës dhe filmave në internet. Përmes këtij procesi për kontrollim, lehtë fitohet qasja deri te IP adresat e aktuara. Në bazë të informacioneve të mbledhura përmes këtij procesi për kontrollim, ndërmerren edhe hapa të ndryshme për ndërprerjen e kësaj dukurie.

Gjithçka incizohet!

Me qëllim të përmirësimit të luftës kundër krimit, UE-ja ka sjellë Direktivën për ruajtjen e të dhënave që është në proces të implementimit në të gjitha vendet evropiane. Korniza rregulluese do të thotë se të dhënat për atë se kush ka biseduar në linjën fikse, telefon celular apo përmes internetit, do të ruhen në afat prej dy vitesh. Kjo gjithashtu ka të bëjë edhe me të dhënat për personat të cilët pranojnë dhe dërgojnë e-mail porosi.

Të incizojnë!

Shumë persona janë të interesuar për të dhënat tuaja personale dhe të incizojnë çdo ditë. Më shumë firma grumbullojnë të dhëna për ty. Policia mund t'i shfrytëzojë këto të dhëna për zbulimin e kriminelëve, ndërsa kriminelët mund t'i shfrytëzojnë për qëllimet e tyre. Firmat

i shfrytëzojnë të dhënat tua personale që të përfitojnë para. Ata dëshirojnë të kenë sa më shumë informacione. Asgjë nuk është falas - ti paguan për të dhënat tua personale. Dhe mbani mend se keni të drejtë në qasjen e të dhënave tua personale që dikush i ka incizuar.

Zhvillimi i teknologjisë është tejet i shpejtuar dhe vazhdimisht ofron mundësi të reja.

Bota e luftërave - World of Warcraft

Në lojën online "World of Warcraft" operatori mund të "shikojë" a shfrytëzon veb-faqe për thyerje të kodeve (code-breaking website) përderisa luan. Nëse shfrytëzon mund të të përjashtojnë nga loja.

Reklama të "sajuar"

Gmail shfrytëzon program i cili i skenon e-mail porositë që i shkruan dhe kërkon fjalë që do japin informatë për atë që je ti i interesuar. Më pas Google i "sajon" reklamën sipas shijes suaj.

Bileta elektronike

Blerja dhe shfrytëzimi i biletave elektronike u mundëson kompanive të jenë të informuara kur dhe ku ke udhëtuar. Këto të dhëna janë ruajtur dhe mund shumë lehtë të shohësh kur dhe ku ke qenë, vetëm me vizitën e kompanisë, përmes veb-faqes.

Shenja dhe ADN

Gjurmët e gishtit, syrit dhe të dhënat tjera biometrike nga dita në ditë shfrytëzohen gjithnjë e më shumë. Në pasaportat e reja të Maqedonisë janë të përfshira të gjitha të dhënat e përmendura biometrike. Në disa shtete është menduar edhe për krijimin e bazës së ADN-së, e cila do të mundësonte kapjen e kriminelëve, por nga ana tjetër ekzistimi i këtyre bazave më të dhëna mund të sjellë deri te keqpërdorimi i tyre.



Mbrojtja e të dhënave personale do të thotë se ekzistojnë rregulla për atë se si të tjerët mund t'i shfrytëzojnë informacionet dhe të dhënat për ty. Shpresojmë se tash ke bazë më të mirë të vendosësh se cilat të dhëna dhe informacione do t'i zbulosh dhe kujt.


Edhe pse do të ketë situata ku nuk do të kesh kontroll të plotë, shpresojmë se tash ndjehesh më i sigurt. Për shkak se në shumë situata, me të vërtetë ti vendos!

DËSHIRON TË DISH MË SHUMË?

Në www.dzlp.mk mund të marrësh më shumë informacione për mbrojtjen e të dhënave tua personale dhe për të gjitha dispozitat ligjore në këtë lëmi. Gjithashtu mund të gjesh edhe linke deri në faqe të tjera të rëndësishme.

Nëse dëshiron të kontaktosh me Drejtorinë për mbrojtjen e të dhënave personale, mund të lajmërohesh në [+39823244-760](tel:+39823244760) apo në e-mail: info@dzlp.mk.

Më shumë informacione për sigurinë dhe mbrojtjen e të drejtës personale dhe të familjes suaj mund të lexoni në internet në www.crisp.org.mk apo www.internetisigurt.org.mk.



CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека
„Св. Климент Охридски“ Скопје


342.738(035)

Ti vendos: Mendime dhe fakte për mbrojtjen e të dhënave tua personale / përkthimi Xhanije Isenil. - Shkup: Fondacioni Metamorfozis : Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale të Republikës Maqedonisë, : 2008. ;24 стр.; илустрац.; 20x20 cm

ISBN 978-9989-2792-4-9 (метаморф)

ISBN 978-9989-2819-3-8 (дирекција)

а) Право на приватност - Прирачници
COBISS.MK-ID 72081162



METAMORPHOSIS 
Foundation for Internet and Society

